

08-2684 dt 05-10-2023

PRISHTINË-PRISTINA




NDËRMARRJA PUBLIKE HIDROEKONOMIKE „IBËR - LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBËR - LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi “Bil Klinton” Nr. 13 Prishtinë, Kosovë, Bulevar “Bil Klinton” Br. 13
Prishtinë, Kosovo.

Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr.05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, neni 21 paragrafit 4, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Statutit Nr.08/868, të datës 30.05.2022, të NPH “Ibër Lepenc”, si dhe Kodin e Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023 mori këtë

V E N D I M



- I. **APROVOHET** korrigjimi i “Planit të biznesit të rishikuar për vitin 2023” të Ndërmarrjes Publike Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” Sh.A. Prishtinë.

A r s y e t i m

Komisioni i Auditimit në mbledhjen e mbajtur me datë 02.10.2023 ka shqyrtuar kërkesën e NJPMNP për korrigjimin e gabimeve në planin e rishikuar të biznesit për vitin 2023. Komisioni i Auditimit pas analizimit me kujdes të kërkesës, të njëjtën e ka aprovuar.

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023, ka shqyrtuar korrigjimin e gabimeve të planit të rishikuar të biznesit për vitin 2023, të cilat u prezantuan nga kryesuesi i Komisionit të Auditimit, dhe se të njëjtat u miratuan nga Bordi i Drejtorëve.

Datë: 05.10.2023


Bajram MUSTAFI
Kryesues i Bordit të Drejtorëve
të NPH “Ibër Lepenc”






NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Priština, Kosovo

Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

**NH "IBËR-LEPENC" SH.A.**
D.D.
08-2683 Dt. 05-10-2023
PRISHTINË-PRISTINA

Plani i biznesit-i rishikuar

2023

KORRIK, 2023

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
Misioni	3
Vizioni	3
Organizimi dhe qeverisja korporative	4
Struktura Organizative	4
Korniza Ligjore	6
Objektivat Strategjike	6
SWOT Analiza	9
Përparësitë	9
Dobësitë	9
Mundësitë	9
Rreziqet	9
Veprimtaria	10
Energjia Elektrike	10
Uji i papërpunuar	10
Ujitja	11
Plani operativ dhe investiv	11
Planifikimi i Burimeve njerëzore	29
Personeli	29
Planifikimi Financiar	30
Planifikimi i Fitimit/Humbjes për vitin 2023	31
Struktura dhe vlera e të hyrave për vitin 2023	31
Shpenzimet operative	31
Plani i zhvlerësimit të aseteve për vitin 2023	33
Parashikimi i rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2023	34
Parashikimi financiar për projektin e Bankës Botërore	35

HYRJE

Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" Sh.A. me seli në Prishtinë është ndërmarrje shumëfunksionale e cila furnizon industrinë, ujësjellësit dhe bujqësinë me ujë të përpunuar si dhe prodhon energji elektrike nga Hidrocentrali i Ujmanit. N.H, Ibër-Lepenc" është themeluar me Vendimin e Kuvendit të Kosovës me 28 shkurt 1967, me seli në Prishtinë. Ndërmarrja është konstituuar në vitin 1986 si Ndërmarrje shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së këtij sistemi shumëfunksional. Ndërtimi i këtij sistemi është paraparë të bëhet në dy faza:

- IBRI (ka përfunduar në vitin 1986)
- LEPENCI (nuk është realizuar akoma)

Ndërmarrja është transformuar në Ndërmarrje Publike N.H. "Ibër-Lepenc" nga UNMIK-u pas vitit 2001. Pas Korporatizimit të Ndërmarrjes, më 01/01/2008, Ndërmarrja është shëndërruar në Ndërmarrje Hidro-Ekonomike "Ibër-Lepenc" Sh.a.. Ndërmarrja është Shoqëri Aksionare në pronësi 100% të Qeverisë së Kosovës. Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/ L-087) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin (Ligji nr. 04/L - 111) dhe (Ligjin nr.03/L-009) NH "Ibër-Lepenc" Sh.A. është njëra nga ndërmarrjet publike qendrore të Republikës së Kosovës e organizuar si Shoqëri Aksionare e cila sipas Ligjit për Shoqëri Tregtare (Ligji nr.06/L-016) përmes Bordit të Drejtorëve, i përgjigjet Qeverisë së Republikës së Kosovës si aksionar i vetëm. Plani i biznesit është dokument bazë për menaxhimin e ndërmarrjes. Ky plan është përpiluar duke i pasur parasysh informatat e vitit 2022 trendet zhvillimore ndër vite dhe kërkesat e sektorëve dhe ofron planifikim të detajuar lidhur me afarizmin e ndërmarrjes për vitin 2023. Në këtë plan përshkruhet afarizmi vjetor i bazuar edhe në strategjinë e ndërmarrjes me qëllim të ofrimit të të gjitha informatave të nevojshme të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve në ndërmarrje. Plani vjetor për vitin 2023 është detalisht i zbërthyer. Pjesa strategjike e këtij plani vazhdimisht monitorohet, rishqyrtohet dhe sipas nevojës mund të ndryshohet nga Bordi i Drejtorëve. Rëndësia e këtij plani është se i njëjti do të shërbej për Bordin dhe Menaxhmentin e ndërmarrjes, si platformë për zhvillimin dhe vendosjen e prioritetëve të investimeve në të ardhmen.

Misioni

Misioni i NH "Ibër- Lepenc" SH.A. është që të ofrojë shërbime sa më kualitative për konsumatorët dhe të rrisë vlerën afatgjatë të aseteve të ndërmarrjes në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare të qeverisjes korporative.

Vizioni

Vizioni i NH "Ibër- Lepenc" SH.A. është Ruajta dhe mirëmbajtja e aseteve ekzistuese dhe rritja e investimeve kapitale, për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj klientëve ekzistues dhe atyre potencial.

Organizimi dhe qeverisja korporative

Struktura Organizative


Ndërmarrja "Ibër- Lepenc" Sh.A. mbikëqyret nga Bordi i Drejtorëve dhe udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv. Sipas strukturës organizative të ndërmarrjes menaxhmenti i lartë i Ndërmarrjes përbëhet nga pozitat në vijim: Kryeshefi Ekzekutiv (KE), Sekretari i Ndërmarrjes, Zytari Kryesor Financiar dhe Zytari për Auditim të Brendshëm. Po ashtu, menaxhmentin e Ndërmarrjes e përbëjnë edhe udhëheqësit e Njësive Afariste, drejtorët Departamenteve dhe udhëheqësit e zyreve si në vijim:

- Njësia afariste Uji dhe Gjenerimi
- Njësia afariste Ujitja
- Financat dhe Kontabiliteti
- Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim
- Departamenti i Prokurimit
- Departamenti i Administratës
- Zyra Ligjore
- Zyra e Burimeve Njerëzore
- Njësia zbatuese e Projektit të Bankës Botërore

Në organogramin e mëposhtëm është e paraqitur struktura organizative e ndërmarrjes:



SKEMA ORGANIZATIVE E NDËRMARRJES NH "IBËR - LEPENC" SH.A.



Korniza Ligjore

Ligji për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 02/L-123), Ligji për Ndërmarrjet Publike - Ligji nr. 03/ L-087) dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/ L-087 (Ligji nr. 04/L - 111), të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë aktet më të larta të cilat e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes. Dokumente tjera në bazë të të cilave udhëhiqet ndërmarrja janë: Statuti, Kodi i etikës dhe rregulloret e brendshme.

Objektivat Strategjike

Mirëmbajtja dhe operimi i infrastrukturës ekzistuese, modernizimi i sistemit, rehabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve janë qëllime dhe synime të ndërmarrjes. Rritja e vlerës së aseteve, maksimizimi i të hyrave me një shfrytëzim sa më efikas të aseteve mbetet prioritet i ndërmarrjes, ndërkaq në planin strategjik zgjerimi i ndërmarrjes në aspektin e aseteve si dhe në aspektin e veprimtarisë mbeten si qëllim.

Për projekte kapitale të mëdha të cilat nuk mund të financohen nga burimet e të hyrave vetanake dhe me qëllim të modernizimit të mëtejshëm të infrastrukturës së Ibër Lepenc-it në planin strategjik afatshkurtër pritet që të negociohet mundësia e përfitimit të donacioneve apo huave të buta nga donatorë të mundshëm. Në bashkëpunim me Bankën Botërore është duke u implementuar projekti me numër P133829 dhe me titull: "Siguria e ujit dhe mbrojtja e kanalit" i cili derivon nga studimi i fizibilitetit dhe financohet nga kredia me numër 5902 XK. Ky projekt ka për qëllim modernizimin e infrastrukturës së kanalit kryesor të Ibër Lepenc-it. Kredia arrinë vlerën prej 15,000,000.00€, përfitues i së cilës është Ibër Lepenc-i.

Gjithashtu, synim i ndërmarrjes është edhe inicimi i realizimit të projektit për ndërtimin e fazës së dytë të projektit "Ibër - Lepenc" – "Lepenci", për të cilin është realizuar studimi i fizibilitetit nga një grant i fituar nga Banka Europiane.

Qëllimi kryesor i ndërmarrjes dhe objektivat e këtij plani janë rritja e vlerës së aseteve, shfrytëzimi më i madh i kapaciteteve si dhe zgjerimi i veprimtarisë e cila do të siguronte rritjen e të hyrave gjatë tri viteve të ardhshme.

Në planin e rishikuar të të hyrave për vitin 2023 është paraparë që të hyrat nga shitja e energjisë elektrike të jenë rreth 70% e të hyrave të përgjithshme. Shitja e ujit të papërpunuar merr pjesë me 28% të të hyrave, ndërsa ujitja pritet të kontribuoj me 2% në të hyrat e përgjithshme të ndërmarrjes. Rritja e të hyrave nga uji i papërpunuar do të përmirësohet me rritjen dhe riaktivizimin e kërkesave të industrisë në të ardhmen.

Në grafikonin e më poshtëm janë paraqitur të hyrat e planifikuara për vitin 2023 sipas veprimtarive të ndërmarrjes:





Figura 1: Paraqitja grafike e pjesëmarrjes së të hyrave sipas veprimtarive për vitin 2023

Tabela 1. Të hyrat aktuale dhe të parashikuara për vitet 2023 dhe 2024 në Euro.

Veprimtaria	Realizimi 2022	Plani 2023	Synimi 2024
Energjia	7'060'943	6'504'707	8,048,035
Uji	2'363'495	2'286'299	2,328,280
Ujitja	176'389	143'000	181,500
Gjithsej	9'600'827	8'934'006	10,557,816

**Figura 2. Pasqyrimi grafik i parashikuar i të hyrave sipas veprimtarive deri në vitin 2024 (në Euro)**

SWOT Analiza

Përparësitë

Ibër Lepenc ka identifikuar përparësitë në vijim:

- Tregu stabil i shërbimeve që ofron Ndërmarrja;
- Operator i vetëm i hidrosistemit në Kosovën qendrore;
- Prodhues i hidro – energjisë;
- Kërkesat në rritje për ujë të papërpunuar;
- Ofrues i vetëm i shërbimeve të ujitjes dhe ujit të papërpunuar;

Dobësitë

Ndërsa dobësitë e identifikuara janë:

- Gjendja ekonomike jo e mirë e disa shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Asetet e vjetruara që kërkojnë mirëmbajtje apo zëvendësim dhe kostoja e tyre është e lartë;
- Shfrytëzim në shkallë të ulët i kapaciteteve për ujitje;
- Mungesa e një infrastrukture moderne-të digjitalizuar të proceseve;

Mundësitë

Disa nga mundësitë të cilat ndihmojnë veprimtarinë e Ndërmarrjes janë:

- Ekzistimi i infrastrukturës operationale;
- Mundësia e gjenerimit të energjisë në kohë të pik-ut;
- Kapacitetet e ujitjes janë shumë më të mëdha se sa kërkesat aktuale të shfrytëzueshme nga fermerët;

Rreziqet

Ibër Lepenci po ashtu ballafaqohet me një numër të rreziqeve të listuara më poshtë:

- Fatkeqësitë elementare natyrore (reshjet e mëdha, rrëshqitjet e tokës, vërshimet etj.) mund të ndikojnë në dëmtimin e aseteve të ndërmarrjes;
- Thatësia ekstreme mund të rrezikojë realizimin e gjenerimit të planifikuar të energjisë elektrike;
- Mos arkëtimi i mjeteve nga klientët me kohë dhe borxhet e këqija;
- Zvogëlimi i sipërfaqeve bujqësore në hidrosistem për shkak të ndërrimit të destinacionit nga toka bujqësore në toka urbane;
- Shpenzimet e larta në sektorin e ujitjes si pasojë e zhvlerësimit të hidrosistemit;
- Shpenzimet e larta të personelit për shkak të mbipunësimit në administratë;
- Ujitjet ilegale të fermerëve;

Veprimtaria

Ibër-Lepenc është shoqëri aksionare dhe si ndërmarrje publike hidroekonomike merret me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit shumë-funksional për furnizim me ujë dhe gjenerim të energjisë elektrike. Asetet kryesore të ndërmarrjes janë:

- **Diga në Ujman**-mundëson akumulimin e ujit i cili përdoret për gjenerimin e energjisë elektrike si dhe Hidrocentrali "Ujman";
- **Kanali kryesor "Pridvoricë – Obiliq"** në gjatësi prej 50 km- mundëson furnizimin e industrisë me ujë të papërpunuar për ftohje për KEK – termocentralet "Kosova A", "Kosova B", Feronikeli dhe për furnizimin e ujësjellësve regional në Mitrovicë dhe Prishtinë të cilët furnizojnë qytetarët me ujë të pijshëm.
- **Rrjeti nëntokësor** -mundëson furnizimin e bujqësisë me ujë për ujitje.

Aktualisht tregjet e NH "Ibër- Lepenc" Sh.A. janë stabile dhe të sigurt. Konsumatorë të ndërmarrjes janë: Future Energy Trading -FET-ED; KEK-u; KRU "Mitrovica", së bashku me ujësjellësin në Vushtrri; KUR "Prishtina" për Drenas; "Feronikeli"; KUR "Prishtina" - për Shkabaj.

Energjia Elektrike

Gjenerimi i energjisë elektrike është një aktivitet shumë i rëndësishëm për ndërmarrjen. Si i tillë, ky aktivitet sjellë të hyra të konsiderueshme dhe duke pasur parasysh kërkesat dhe mungesën e energjisë elektrike në Kosovë dhe rajon, tregu i energjisë elektrike konsiderohet një treg i sigurt i cili do të vazhdojë ta mbajë stabile gjendjen financiare të ndërmarrjes për një kohë të gjatë.

Uji i papërpunuar

Kërkesat aktuale për ujë të papërpunuar janë më të vogla se sa mundësitë dhe kapacitetet me të cilat disponon Ndërmarrja.

Pritet rritja e kërkesave prej bujqve për ujitje si rrjedhojë e përmirësimit të pozitës së bujqësisë në vend.

Kërkesat e industrisë do të rriten edhe më tej në të ardhmen, me rritjen e kërkesave eventuale edhe klientët potencial. Një ndër to parashihet të jetë termocentrali "Kosova e Re" i cili parashihet të ndërtohet në të ardhmen për të stabilizuar gjendjen e energjisë elektrike në Kosovë.

Ujitja

Ndërmarrja "Ibër- Lepenc" ka një sistem modern të ujitjes, i cili shtrihet në pjesën veri-lindore dhe qendrore të Kosovës me qëllim të rritjes së prodhimtarisë bujqësore në këtë region. Megjithatë, duhet theksuar se bazuar në jetëgjatësinë e hidrosistemit, i njëjti është zhvlerësuar.

Në vitin 2023 N.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A planifikon që sipas rregullores për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes më datë 01.06.2023, të filloj mbushjen e sistemit të ujitjes dhe atë në rreth 11,000 ha, por bazuar në kërkesat e fermerëve si dhe bazuar në sipërfaqet e ujitura në vitet e kaluara, planifikojmë që fermerët do të ujitin **1,300** ha: në Vushtrri **700** ha, në Shkabaj **400** ha dhe në Komoran **200** ha.

Tabela 2: Sipërfaqet e ujitura për vitin 2022-2024 dhe të planifikuara për ujitje në vitin 2023 në hektarë - ha.

Njësia Punuese	Sipërfaqet projektuese	Sipërfaqet e rehabilituara	Sipërfaqet e ujitura	Sipërfaqet e planifikuara	Sipërfaqet e planifikuara
			2022	2023	2024
1	2	3	4	5	6
Vushtrri	7,200.00	4,500.00	734.28	700.00	710.00
Shkabaj	7,100.00	2,500.00	685.81	400.00	450.00
Komoran	5,620.00	4,000.00	459.63	200.00	490.00
Gjithësejt	19,920.00	11,000.00	1,879.72	1,300.00	1650.00

Plani operativ dhe investiv

Plani i operimit dhe mirëmbajtjes për vitin 2023 është përpiluar në bazë të kërkesave të shfrytëzuesve të ujit të papërpunuar për Ujësjellësit dhe industrinë: FET-ED; KEK-u; KRU "Mitrovica", së bashku me ujësjellësin në Vushtrri; KUR "Prishtina" për Drenas; "Feronikeli"; KUR "Prishtina" - Shkabaj.

Uji i papërpunuar

Ujësjellësi regional i Mitrovicës do të furnizohet me ujë të papërpunuar bazuar në ujëmatës në sasi prej mesatares $0.664 \text{ m}^3/\text{sec}$, ndërsa Ujësjellësi i Prishtinës bazuar në ujëmatës (për Drenas) në sasi prej $0.105 \text{ m}^3/\text{sec}$. Furnizimi me ujë të papërpunuar për KUR "Prishtina"-Shkabaj me sasi maksimale prej $0.700 \text{ m}^3/\text{sec}$. Çmimi për këtë furnizim është 0.0433 €/m^3 . Tarifat apo çmimi i ujit të papërpunuar për ujësjellësit është i rregulluar nga ARRU me sistem dytarifor: për ujësjellësin e Mitrovicës me çmim prej 0.0201 €/m^3 , dhe për ujësjellësin e Prishtinës 0.0433 €/m^3 .

Termocentrali "Kosova B" dhe "Kosova A" furnizohen me ujë të papërpunuar në sasi 0.340 m³/sec dhe 0.5 m³/sec, respektivisht . Çmimi për këtë furnizim është 0.065 €/m³. Feronikeli furnizohet me 0.067 m³/sec. Çmimi për këtë furnizim është 0.085 €/m³.

Gjenerimi i energjisë elektrike

Gjenerimi i energjisë elektrike varet nga kushtet hidrologjike dhe niveli i ujit në akumulimin e Ujmanit. Duke qenë se niveli aktual i ujit në liqe është në kuotat optimale si rrjedhojë e kushteve hidrometeorologjike shumë të favorshme, krahasuar me mesataret shumë vjeçare, ndërmarrja ka rritur prodhimin e energjisë elektrike në gjysmën e parë të vitit 2023 më shumë se 83000MWh. Ky prodhim është mbi mesataren shumëvjeçarë të gjenerimit në Hidrocentral. Kjo rritje është bërë me kujdes të shtuar, duke pasur parasysh edhe nevojat e furnizimit me ujë të konsumatorëve me interes nacional siç janë KEK-ut, KUR Prishtina, KUR Mitrovica.

Tabela në vijim pasqyron planin për gjenerimin energjisë elektrike dhe të hyrat sipas veprimtarive në vitin 2023:

Tabela 3: Çmimet, gjenerimi dhe të hyrat e planifikuara për 2023

Nr	Produkti	Çmimi/Njësi - €	Njësia	Sasia	Euro
1	Energjia elektrike				6'504'707
	Energjia e prodhuar	35.50	MWh	119'071	6'504'707
2	Uji i papërpunuar		m³	59'350'222	2'286'299
	Ujësjiellës	0.0201 dhe 0.0433	m ³	44'781'536	1'303'678
	Kosova A dhe B	0.065	m ³	12'785'870	831'082
	Feronikeli	0.085	m ³	1'782'817	151'539
3	Ujitja	110	ha	1'300	143'000
4	Të hyra tjera				4'643
Gjithësejt (1+2+3+4)					8'938'649

Tabela 4: Sasitë e planifikuara të gjenerimit të energjisë sipas muajve në vitin 2023

Muaji	Emërtimi	Sasia MWh	Çmimi - €	Të hyra sipas kontratës € Realizimi 2023	Të hyrat nga jobalanca Realizimi 2023	Të hyra - € Totali 2023
1	2	3	4	5	6	7=(5+6)
Janar	Energjia e prodhuar	16'267		18'176	1'448'976.22	1'467'152
Shkurt	Energjia e prodhuar	17'413		38'624	1'231'908.42	1'270'532
Mars	Energjia e prodhuar	13'480		78'384	740'244.11	818'628
Prill	Energjia e prodhuar	17'726		142'000	723'249.74	865'250

Maj	Energjia e prodhuar	13'894		177'784	393'672.25	571'456
Qershor	Energjia e prodhuar	18'790		213'000	535'438.08	748'438
Korrik	Energjia e prodhuar	5'000	35.50			177'500
Gusht	Energjia e prodhuar	5'000	35.50			177'500
Shtator	Energjia e prodhuar	3'000	35.50			106'500
Tetor	Energjia e prodhuar	3'000	35.50			106'500
Nëntor	Energjia e prodhuar	3'000	35.50			106'500
Dhjetor	Energjia e prodhuar	2'500	35.50			88'750
Gjithsej:	Energjia e prodhuar	119'071				6'504'707

Furnizimi me ujë për konsumatorët

Tabela 5: Sasitë e shpenzuara mujore të ujit sipas shfrytëzuesve – Plani 2023

Shënim: shifrat e dhëna janë në m³

Muajt	Ujësjetillësi Mitrovicë	Ujësjetillësi Drenas	KUR Prishtina	Ujësjetillësi Vushtrri	TC Kosova B	TC Kosova A	Feronikeli	Ujitja	Gjithsejt
Janar	1,544,512	278,271	951,280	560,991	937,440		102,147		4,374,641
Shkurt	1,538,807	202,551	815,664	555,278	846,720		82,009		4,041,029
Mars	1,668,303	246,077	1,168,416	580,572	937,440		75,604		4,676,412
Prill	1,748,245	285,732	1,270,112	612,642	907,200		118,342		4,942,273
Maj	1,617,239	247,827	1,176,264	585,580	937,440		139,694		4,704,044
Qershor	1,660,984	203,713	963,760	602,497	907,200		202,171		4,540,325
Korrik	1,962,233	355,164	1,487,971	714,471	942,127	534,310	162,089	1,690,000	7,848,366
Gusht	1,780,147	366,281	1,424,198	668,332	942,127	665,388	125,979	1,690,000	7,662,452
Shtator	1,835,532	301,503	1,172,232	520,992	911,736	520,992	191,635	845,000	6,299,622
Tetor	1,686,562	301,912	1,211,306	538,358	941,886		201,050		4,881,075
Nëntor	1,685,405	295,610	1,172,232	520,992	911,977		192,050		4,778,266
Dhjetor	1,659,275	285,845	1,211,306	538,358	941,886		190,046		4,826,717
Gjithsejt	20,387,245	3,370,486	14,024,741	6,999,063	11,065,180	1,720,690	1,782,817	4,225,000	63,575,222

Tabela 6: Plani i të hyrave mujore nga sasitë e ujit sipas shfrytëzuesve - Plani 2023*Shënim: shifrat e dhëna janë në Euro*

Muajt	Ujësjetësi Mitrovicë	Ujësjetësi Drenas	KUR Prishtina	Ujësjetësi Vushtrri	TC Kosova B	TC Kosova A	Feronikeli	Ujitja	Gjithsejt
Janar	31,045	12,049	41,190	11,276	60,934		8,682		165,176
Shkurt	30,930	8,770	35,318	11,161	55,037		6,971		148,187
Mars	33,533	10,655	50,592	11,669	60,934		6,426		173,810
Prill	35,140	12,372	54,996	12,314	58,968		10,059		183,849
Maj	32,507	10,731	50,932	11,770	60,934		11,874		178,747
Qershor	33,386	8,821	41,731	12,110	58,968		17,185		172,200
Korrik	39,441	15,379	64,429	14,361	61,238	34,730	13,778		243,356
Gusht	35,781	15,860	61,668	13,433	61,238	43,250	10,708		241,939
Shtator	36,894	13,055	50,758	10,472	59,263	33,864	16,289		220,595
Tetor	33,900	13,073	52,450	10,821	61,223		17,089		188,555
Nëntor	33,877	12,800	50,758	10,472	59,279		16,324	143,000	326,509
Dhjetor	33,351	12,377	52,450	10,821	61,223		16,154		186,376
Gjithsejt	409,784	145,942	607,271	140,681	719,237	111,845	151,539	143,000	2,429,299

Ky plan mund të arrihet me operim dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të aseteve ekzistuese dhe investime në rehabilitimin e aseteve.

Në veçanti do të bëhen investime në:

- *Infrastrukturë*
 - Rehabilitimi i kanalit kryesor parashihet të kryhet me planin e biznesit për vitin 2024 pasi që ky rehabilitim ka filluar në vitin 2023 nga mjetet e huasë së lejuar nga Banka Botërore.
 - Revitalizimi dhe modernizimi i sistemit të "Ibër-Lepenc" -it,
 - Digjitalizimi i dokumentacionit teknik të ndërmarrjes.
- *Ngritjen e kapaciteteve*
 - Trajnime profesionale të menaxhmentit dhe stafit tjetër;

Njësia afariste Uji dhe Gjenerimi

Njësia afariste Uji dhe Gjenerimi në planin e biznesit për investime kapitale ka paraparë alokimin e mjeteve për këto investime:

- **Sanimi i rrëshqitjes së dheut në Babin Most dhe i kanalit në segmentin Mihaliq-Besi-Gračankë**

Si pasojë e lëvizjeve tektonike, të njohura për ne si ndërrmarje në këtë pjesë, është mëse e nevojshme të bëhet sanimi i rrëshiqitjes së dheut me anë të pilotimit të asaj pjese, meqenëse është dëmtuar edhe kanali i cili është i rëndësisë së veçantë, me anë të cilit bëhet i mundur dërgimi i ujit për TC Kosova A dhe për ujitjen e fushës së Prishtinës. Përmes këtij projekti synohet të sanohet rrëshiqitja e dheut, kampadat e dëmtuara, sanimi i nënkalesës tek ura e fshatit Babin Mostë si dhe sanimi i fugave të dëmtuara me kohë përgjatë këtij segmenti.

Ky projekt është tenderuar në të kaluarën dhe punimet kanë filluar mirëpo ka mbetur i pa përfunduar. Si pasojë e lëvizjeve tektonike për gjatë kanalit në fshatin BabinMost, janë shkaktuar rrëshqitje të dheut të cilat e rrezikojnë bazën e kanalit. Sanimi i kësaj rrëshqitje duhet të bëhet me pilotim. Ky kanal është i rëndësisë së veçantë, pasi me anë të tij bëhet furnizimi me ujë i TC Kosova A, furnizimi me ujë për ujitjen tokave bujqësore si dhe dërgimin e ujit për mbushjen e liqenit të Badofcit. Pjesë e këtij projekti është dhe sanimi i nën kalesës së dëmtuar afër urës së fshatit BabinMost, sanimi (rivendosja) e fugave delatuese të dëmtuara me kohë për gjatë këtij segmenti Mihaliq-Besi-Gračankë.

➤ **Sanimi dhe renovimi i stacioneve pompikë në Bivolak**

Meqenëse është i nevojshëm një riparim emergjent, është parashikuar që të kryejmë një izolim të jashtëm për të shmangur ndërhyrjet në ujërat nëntokësore brenda objektit, me qëllim që të parandalohet dëmtimi i infrastrukturës.

Me këtë masë emergjente, synojmë të sigurojmë që infrastruktura të funksionojë normalisht dhe të jetë e qëndrueshme. Duke kryer riparimet dhe rindërtimet e nevojshme, do të përmirësojmë kushtet e punës dhe rrisim sigurinë operative.

➤ **Sanimi i Objekteve Ndërtimore dhe Stacioneve Pompikë**

Me këtë projekt parashihet riparimi i objekteve ndërtimore të objekteve ndarëse (Vernicë, Mihaliq, Hamidi, Vasilev) si dhe stacioneve pompikë (Besi, Çagllavicë, Pantinë, Samadrexhë, Fushticë, Gjurashin, Koraticë Krashticë), sanimi i çatisë, dritareve dhe izolimi i tyre në aspektin hidrotermik. Po ashtu, duhet të riparohet e gjithë infrastruktura përcjellëse, ndërtimi i nyjeve sanitare, rregullimi i ujit të pijshëm, duke u kyçur në rrjetin e ujësjellsave rajonal, apo hapjen e puseve, si dhe izolimi i bazenëve kompenzues tek të gjitha stacionet pompikë. Me tutje, Objektet në fjalë janë të ndërtuara në fund të viteve 70-ta dhe fillim të viteve të 80-ta dhe si të tilla janë të zhvlerësuar. Për këtë arsye është i nevojshëm rehabilitimi i këtyre objekteve. Me sanimin e këtyre objekteve përveç përmirësimit të infrastrukturës ndërtimore që përfshinë sanimin e dyerve, dritareve çative dhe aspektin hidrotermik, me këtë projekt arrihet edhe realizimi i vendimit të Qeverisë për eficiencën e energjisë. Po ashtu, duhet theksuar se që nga koha e ndërtimit, nyjet sanitare janë shumë primitive dhe nuk kemi pasur furnizim me ujë.

➤ **Riparimi dhe mirëmbajtja e Lartë Përçuesve 10kV dhe 35kV**

E gjithë infrastruktura e ndërmarrjes sonë furnizohet nëpërmjet lartëpërçuesve. Ne si ndërmarrje jemi të pavarur nga rrjeti për furnizim të shfrytëzuesit të fundmë, sepse kemi lartë përques të nivelit 10kV dhe 35kV, prandaj për furnizim dhe operim normal pa probleme është e domosdoshme mirëmbajtja permanente e tyre (mirëmbajtje e rregullt vjetore, si pasojë e shumë faktorëve, siç janë mungesa e stafit adekuat për riparime, pajisje specifike, etj). Gjithsej janë: 19 LP 3 LP janë 35kV, 10 janë 10kV, në pjesën veriore janë 6 LP (5 janë 10kv dhe 1 35kv), pra në total rreth 120km.

Mirëmbajtja e rregullt e LP është e nevojshme për furnizim permanent me energji elektrike gjatë të gjithë kohës. Duhet theksuar se defektet më të shpeshta mund të ndodhin në izolator, shkëputje të linjave, dëmtim i kokave kabllorëve të cilat kërkojnë sanim urgjent. Nga sa është thënë më lartë, ne si ndërmarrje nuk kemi ekupe dhe pajisje adekuate për sanim urgjent të këtyre defekteve.

Prandaj është e nevojshme që të kemi një kompani profesionale për sanimin e defekteve eventuale.

➤ **Furnizim me material teknik për punëtorinë mekanike në Shkabaj**

Ky furnizim është i nevojshëm për shkaqe operative të mirëmbajtjes, për punëtorinë mekanike e cila i shërben tërë hidrosistemit. Materiali teknik do të shërbejë për mirëmbajtjen e të gjithë grilave përgjatë tërë gjatësisë së kanaleve të hidrosistemit, mirëmbajtjen e rrethojave të objekteve ndarëse dhe stacioneve pompikë, mirëmbajtjen e njësive punuese për ekzekutimin e punëve me metale.

➤ **Shqyrtimi i transformatorëve dhe mbrojtjeve**

Pajisjet tona elektro-energjetike siç janë transformatorët, datojnë që nga koha e ndërtimit të hidrosistemit. Në mënyrë që të rritet siguria në punë, cilësia e shërbimeve dhe jetëgjatësia e hidrosistemit, duhet të bëhen zëvendësime elektro-energjetike duke vlerësuar dielektrikun e vajit në transformatorë, rezistencën e izolimit, matjen e kondensatorëve dhe shqyrtimin e mbrojtës. Këto janë procedura që duhet të bëhen për çdo vit, sepse janë të rregulluara me anë të standardeve të sigurisë dhe cilësisë, kodit të rrjetit, kodit të standardeve elektrike, standardeve të sigurisë së operimit etj. Për më tepër, këto procedura parashihen edhe përmes dokumentacionit për mirëmbajtje të aseteve elektro-energjetike të hartuara nga ana e KOSTT-it dhe aprovuara nga ZRRE si dhe standardeve ndërkombëtare IEC 697, IEC 676, IEE: C57.120.00, C57.120.98 dhe C57.120.113.

➤ **Ndërrimi i ndërprerësve 10kV në Stacionet Pompikë Gjurashin, Krashticë dhe në Njësine Punuese Shkabaj**

Këto stabilimente duhet të ndërrohen për arsye se ndërprerësit aktual nuk janë të sigurt dhe paraqesin rrezik për operatorët nëpër stacione pompikë. Për më tepër, këto stabilimente janë

që nga fillimi i funksionalizimit të këtyre SP-ve dhe në shumë raste kemi hasur në probleme funksionale të tyre.

Meqenëse në një të ardhme të afërt pritet të ndërrohet edhe transmetimi i energjisë nga 10kV në 20kV, këto stabilimente do të jenë kompatible me këtë transformim.

➤ **Ndërrimi i Ridrejtuesit 380V(AC) / 110V (DC) / 24V (DC) në Stacionin Pompik Besi**

Meqenëse gjatë sezonës së ujitjes kemi hasur në vështirësi teknike si pasojë e dëmtimit nga zhvlerësimi i ridrejtuesit me anë të cilit bëhet i mundur komandimi i pultit dhe stabilimenteve tjera është më se i domosdoshëm ndërrimi i tij për funksionimin normal të pultit komandues dhe të gjitha stabilimenteve elektroenergjetike dhe mbrojtëse.

➤ **Ndërrimi i sistemit hidraulikë për objektet ndarëse në Hamidi, Mihaliq, Vërnice dhe Vasilevë**

Komandimi i portave në ndarëse bëhet me anë të sistemit elektrik dhe hidraulik. Tri prej tyre nuk janë duke funksionuar mirë dhe riparimi i tyre është i pamundur për shkak të sistemit të vjetër të ndërtimit. Në mënyrë që të mundësohet ndërlidhja e tyre me sistemin e SCADA-së dhe për ta lehtësuar funksionimin normal të tyre nga dhoma e kontrollit është e domosdoshme të bëhet zëvendësimi i sistemit aktual me një sistem të ri i cili i përshtatet formatit aktual të SCADA-së.

➤ **Vendosja e elektromotorve dhe mekanizmit (AUMAVE) për hapjen dhe mbylljen e valvulave në Bivolak dhe riparimi i pompave të drenazhës në Besi**

Me qëllim të modernizimit të infrastrukturës, duke integruar pultet e automatizuara dhe sistemin SCADA për të lehtësuar operimin dhe rritur sigurinë në punë, është e nevojshme të pajisen këto valvula Ø=600 me mekanizmin (AUMAVE). Në Besi, për shkak të dëmtimit të pompave të drenazhit është shumë e nevojshme të bëhet riparimi i tyre për të siguruar mbrojtjen e objektit dhe infrastrukturës nga ujërat nëntokësore.

➤ **Studimi i fizibilitetit për sistemin hidraulik në objektet ndarëse, pulteve komanduese dhe modernizimi për rritjen e efikasitetit në stacione pompike**

Studimi i fizibilitetit për infrastrukturën tonë përfshinë katër objekte ndarëse dhe trembëdhjetë stacione pompike. Ndër to, dy stacionet kryesore, SP Besi dhe SP Bivolak, kanë një infrastrukturë me teknologji dhe pajisje dyzet vite të vjetër. Kjo ka sjellë sfida të ndryshme, veçanërisht në rastet e dëmtimit, ku riparimet janë kompleksde dhe vështirë është të gjejmë pjesë të përshtatshme. Mbi të gjitha, këto stacione konsumojnë energji të madhe, duke aktivizuar maksigrafin (një lloj tarife për energjinë e konsumuar) e cila ka si pasojë një rritje të faturave për energjinë elektrike. Për këtë arsye, ky studim synon të ofrojë zgjidhjet më të mira teknike, përfshirë përpilimin e dizajnit dhe parametrave për ndërrimin e infrastrukturës elektroenergjetike, pulteve komanduese në SP, si dhe mundësinë e

instalimit të softstarterave apo starterëve frekuencore në pompat ekzistuese në SP Besi dhe SP Bivolak. Ky veprim do të lejojë motorët të mos nisin me kapacitetin e plotë, por të rritet ngarkesa gradualisht, duke shmangur aktivizimin e maksigrafisë dhe si rrjedhojë, do të rritet efikasiteti elektrik. Sa i përket objekteve ndarëse (ON-ve), për të cilat kemi një infrastrukturë hidraulike gjysmë funksionale, synojmë të marrim zgjidhjet më të mira teknike për komandimin e tyre me anë të një sistemi hidraulik të ri dhe integrimin e tyre në SCADA. Me këtë veprim synojmë përmirësimin e funksionimit të këtyre objekteve dhe përdorimin e një teknologjie më të avancuar.

➤ **Traktor për pastrimin e kanaleve sekondare**

Pasi pajisja aktuale është amortizuar në shumë mënyra dhe çdo vit hasim probleme dhe kemi nevojë për riparime, është e domosdoshme të sigurojmë një traktor të ri të specializuar për pastrimin e kanaleve të brendshme, për shkak të nevojës për pastrimin e kanaleve sekondare në mënyrë efikase.

➤ **Gjenerator diesel 150kv për Hidrocentralin e Ujmanit dhe gjenerator 10kv për Komoran**

Për të përmirësuar furnizimin me energji në Ujman është e nevojshme të ndërrojmë gjeneratorin aktual, i cili është i vjetër dhe i amortizuar. Në këtë kontekst, kemi nevojë për një gjenerator të ri me kapacitet 150kVA. Në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike ky gjenerator do të na mundësojë furnizimin e pajisjeve, pulteve komanduese, sinjalistikës, si dhe do të përdoret për furnizimin vetanë në HC të stabilimenteve tjera elektro-makinerike. Kapaciteti i kërkuar për gjeneratorin është në përputhje me ngarkesat në sistem.

Sa i përket gjeneratorit 10kVA për Komoran, vlenë të potencohet se gjeneratori është i amortizuar. Prandaj është më se e nevojshme që të furnizohemi me një të ri për shkak të rëndësisë kyçe gjatë punimeve të ndryshme në terren, duke përfshirë prerjen e gypave, largimin e ujit me pompa nga pusetat dhe saldimet e gypave dhe grilave.

➤ **Ndërtimi dhe vendosja e urave metalike për këmbësor përgjatë kanalit kryesor**

Pas takimeve të zhvilluara me KFOR-in dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, është diskutuar për mundësinë e ndërtimit të urave të reja për këmbësor. Kjo ide vjen si përgjigje ndaj humbjes së jetës së një qytetari në kanalin tonë.

Gjatë këtyre diskutimeve, qytetarët kanë bërë kërkesën për ndërtimin e më shumë urave për këmbësor, dhe bazuar në kërkesat e tyre, ka propozuar që të vendosen minimumi nëntë ura të reja. Një ndër aspektet që është paraparë është që formati i këtyre urave të jetë i njëjtë me të projektit ekzistues "WSCPP".

Me ndërtimin e këtyre urave të reja, synohet të rritet siguria dhe këmbësorve të ju lehtësohet lëvizja e sigurt mbi kanal. Kjo është një masë e rëndësishme që është planifikuar të merret për të përmirësuar infrastrukturën përgjatë kanalit.

➤ **Furnizimi dhe montimi i tabelave sinjalizuese përgjatë kanalit kryesor**

Duke pasur parasysh numrin e tyre dhe gjatësinë e kanaleve, duke përfshirë kanalin kryesor dhe kanalet sekondare, si dhe dëmtimet aktuale në një pjesë sinjalizueseve aktual. Është e rëndësishme të rivendosim këto sinjalizuese me qëllim të vetëdijesimit lidhur me rreziqet dhe për të parandaluar hedhjen e mbeturinave.

Në projektin tonë, kemi vendosur sinjalizues të formateve më të mëdha. Çmimi i caktuar për to është një vlerë referente e tregut dhe besojmë se do të plotësojë nevojat tona. Një ndër qëllimet kryesore është të sensibilizojmë qytetarët dhe të krijojmë vetëdijesim lidhur me ndotjen dhe rreziqet që i shoqërojnë. Përdorimi i sinjalizuesve efikasë dhe funksionalë është thelbësor për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin publik. Numri i përafërt i tyre është 70 tabela sinjalizuese.

➤ **Hidroizolimi i bazeneve kompensuese në stacionet pompike**

Pasi që kemi dëmtime në elementet konstruktive të mureve dhe pllakave të bazeneve si rezultat i degradimit të betonit dhe rrjedhjeve të vazhdueshme, riparimi i bazeneve akumuluese është shumë i nevojshëm. Kjo është një masë që synon të ruajë objektet nga ujërat e jashtme.

Njësia afariste Ujitja

Njësia Afariste Ujita planifikon të investoj në përmirësimin e infrastrukturës dhe lehtësimin e punëve në teren për punëtorët e kësaj njësie.

➤ **Furnizim me fazoneri**

Bazuar në gjendjen e depove të njësive punuese Vushtrri, Shkabaj dhe Komoran, njësia afariste "Ujitja" për vitin 2023 ka paraparë furnizimin me fazoneri të cilat janë shumë të nevojshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin e rregullt të sistemit të ujitjes. Duke pasur parasysh kalimin e jetëgjatësisë së hidrosistemit, dëmtimet e paqëllimshme të fazonerive që shkaktohen nga fermerët si dhe shumë raste dëmtimet dhe vjedhjet e tyre nga njerëz të papërgjegjshëm na imponojnë që të kemi stoke të fazonerive në depot tona. Pjesët fazonerike që më shumti dëmtohen janë pjesët mbitokësore siç janë: Hidrantat, pusetat kryzqëzimet e tubacioneve dhe valvolat e ndryshme. Por gjatë punimeve të tokës dhe gjatë ndërtimeve të ndryshme ndodh që të dëmtohen edhe pjesët nëntokësore siç janë: SSP, FFR, vertikalet si dhe tubacionet.

➤ **Ndërtimi i Garazhit (depo për ruajtjen e fazonerive) dhe Rehabilitimi i Çatisë së Objektit të Njesisë Punuese Komoran**

Njësia Afariste "Ujitja" për vitin 2023 planifikon ndërtimin e një garazhe (Depo në Njësinë Punuese Komoran) që do të shërbente për ruajtjen e pjesëve fazonerike nga faktorët e jashtëm siç janë dielli dhe të reshurat atmosferike. Përkundër ndërtimit të një depoje të madhe në të kaluarën, e njëjta nuk ka qenë e mjaftueshme edhe për gypat që gjenden në këtë njësi. Prandaj

në planin e biznesit për vitin 2022 kemi paraparë ndërtimin e një depoje. Për ndërtimin e depos duhet të sigurohet leja ndërtimore nga komuna e Drenasit, ku për këtë procedurë nevojitet certifikata e pronësisë dhe parcelës ku do të ndërtohet depoja. Sipas Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, parcela në të cilën gjendet njësia punuese Komoran, nuk është në emrin e NH "Ibër-Lepenc". Vonesat e shkaktuara janë si pasojë e procedurave të vërtetësisë së parcelës, prandaj ky projekt duhet të parashihet për implementim gjatë vitit 2023. Gjithashtu në kuadër të këtij investimi është parapare edhe rehabilitimi i çatise së objektit të Njesisë Punuese në Komora. Çatia e objektit ka pësuar dëmtime si pasojë e vjetërsisë, duke u bërë e paqëndrueshme dhe duke lejuar rrjedhën e ujit në objekt gjatë kohës së reshjeve të shiut. Andaj, është planifikuar renovimi, për të siguruar që çatia të jetë funksionale për shfrytëzim në të ardhmen, dhe të sigurojë një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm për punë në këtë njësi.

➤ **Furnizim me lidhëse riparuese (shellne)**

Për shkak të amortizimit të tubacioneve të vjetra si dhe mirëmbajtjes më të lehtë të rrjetit të sistemit të ujitjes, Njësia Afariste "Ujitja" planifikon që këtë vit të furnizohet me Lidhëset Riparuese. Lidhëset Riparuese do të përdoren për riparimin (sanimin) e tubacioneve me dëmtime të vogla siç janë shpimet, plasaritjet si dhe dëmtimet tjera natyrore me qëllim të lehtësimit të punës gjatë mirëmbajtjes së rrjetit të sistemit të ujitjes.

Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim

Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim për vitin 2023 ka paraparë të nevojshme këto investime kapitale:

➤ **Instalimi i Video- Kamerave në njësitë punuese Shkabaj, Komoran, Vushtrri, në Objektet Ndarëse dhe Stacionet Pompikë**

Qëllimi i këtij projekt propozimi është rritja e sigurisë së përgjithshme dhe ruajtja e aseteve të ndërmarrjes. Duhet theksuar se deri më tani nuk ka pasur fare Video-Vëzhgim nga kamerat monitoruese në objektet e lartshënuara.

Me anë të këtij projekti synojmë ta rrisim sigurinë në të gjitha objektet si dhe monitorimin nga distanca të infrastrukturës dhe personelit në mënyrë që të bëhet i mundur në raste të veçanta edhe kontrolli i brendshëm.

Efekti i instalimit të Video-Kamerave rritë sigurinë e përgjithshme, rrit imazhin e ndërmarrjes dhe eventualisht në rast të ndonjë problemi Video-Kamerat mund të sqarojnë me lehtësi çdo ngjarje të ndodhur. Mbikëqyrja me video- Kamera në vendin e punës mbron si kompaninë ashtu edhe punonjësit e saj. Rëndësia e mbikëqyrjes me video kamera në vendin e punës e justifikon koston investive. Kamerat do të rexhistrojnë 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

Kamerat e sigurisë ofrojnë mundësinë për të vëzhguar proceset e ndërmarrjes në kohë reale, duke përfshirë edhe kohën kur është errësirë. Teknologjitë e sotme infra të kuqe, me ngjyra të plota dhe të tjera të shikimit të natës, jo vetëm që lejojnë kamerat e sigurisë të shohin natën, por edhe ofrojnë imazhe/video të qarta. Imazhet që janë të domosdoshme për të përshkruar me saktësi atë që po ndodh brenda ose rreth objekteve të Ndërmarrjes Ibër-Lepenc.

➤ **Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve të Ibër Lepencit për prodhim të energjisë alternative**

Energjia Sollare/diellore mund të përdoret për një sërë aplikimesh, duke përfshirë prodhimin e energjisë, ngrohjen dhe ndriçimin. Reduktimi i varësisë nga lëndët djegëse fosile, duke rritur përdorimin e energjisë diellore, NH "Ibër-Lepenc" është në gjendje të kontribuoj në zvogëlimin e varësisë të saj nga karburantet fosile, të cilat po bëhen gjithnjë e më të shtrenjta.

Qëllimi i këtij projekti është të sigurojë energji elektrike të konsiderueshme për nevojat e vendit në Kosovë me një kapacitet total panelesh diellore sipas kushteve teknike të cilat edhe do i determinojnë kapacitetet në KW me kapacitet total të inverterëve PV jo më pak se Totali KW i përcaktuar nga fizibiliteti i këtij projekti dhe ruajtjen totale të bankës së Baterive (Tot. kWh).

Pra nëpërmes këtij fizibiliteti është paraparë të përcaktojmë sistemin më të mirë, natyrën dhe standardet më të larta të cilësisë për sigurimin dhe instalimin e sistemit Solar.

➤ **Zgjidhje për përmirësimin e sigurisë kibernetike si dhe parandalimi i incidenteve të sigurisë brenda infrastrukturës së IT në Ibër Lepenc**

Një nga problemet themelore, në nivel botëror, me të cilin merret ekonomia botërore është menaxhimi i incidenteve të sigurisë brenda infrastrukturës së teknologjive informative të mjediseve të rëndësishme në nivel të shtetit të një vendi. Madje këto koncepte janë temë edhe në Forumin Ekonomik Botëror, gjë që tregon se tema e trajtuar është e një rëndësie strategjike për funksionimin e sistemeve për mbrojtjen kibernetike në Ibër Lepenc – IL.

Incidentet e sigurisë së TI-së mund të rezultojnë ose në ndërprerjen e funksionimit të vetë mjediseve të TIK-ut, ose në lejin e hakerëve të marrin përsipër të dhënat apo edhe kontrollin mbi sistemet e informacionit me rëndësi të mëdha. Sfida kryesore nuk është vetëm investimi i fondeve në zgjidhje të ndryshme në fushën e sigurisë së IT-së, por stafi i cili duhet të menaxhojnë zgjidhje komplekse në fushën e caktuar. Mungesa e kuadrove profesionale nuk duhet të jetë arsye për mos aplikimin e zgjidhjeve adekuate në fushën e sigurisë së sistemeve informative, sepse kjo rrezikon funksionimin e sistemeve në IL.

Për tejkalimin e këtij problemi, i cili ekziston edhe në Ibër Lepenc planifikohet zgjidhje që mundëson përmirësimin e sigurisë së mjedisit TIK në nivel të IL. Zgjidhja mundëson që incidentet e mundshme të sigurisë të shihen nga lokacioni i centralizuar i Zyrës së IT-së përpara se të ndodhin në mjedisin e IL. Duke e vendosur pajisjet në lidhjen e internetit përballë mjedisit të caktuar, është e mundur të inspektohet trafiku që vjen në mjedisin e caktuar dhe të pastrohet nga përmbajtjet e mundshme të dyshuar.

Në të njëjtën kohë, nuk ka nevojë për të menaxhuar apo ndryshuar infrastrukturën ekzistuese të TI-së në IL. Nga zyrat qendrore, ekipi i IT i cili menaxhon zgjidhjet e sigurisë së TI-së, kontrollon trafikun që vjen nga lokacione të ndryshme, krahason atë informacion me informacionin e disponueshëm për incidentet e sigurisë së TI-së që ndodhin në nivel botëror,

dhe merr vendime dhe raporton mbi përmbajtjen e përmbajtjes së mundshme të dyshuar dhe për implikimet e mundshme të depërtimit të malware të caktuar.

Faza fillestare nënkupton që trafiku të inspektohet në zyrat kryesore.

Duke marrë parasysh që një numër i madh prodhuesish në treg kanë një kohë dorëzimi/liferimi në mënyrë të papranueshme të gjatë dhe/ose të paparashikueshme, është e nevojshme të zgjidhet një zgjidhje e prodhuesit që ka një kohë liferimi të pajisjeve prej 30 ditësh, në mënyrë që të zbatohet projekti sa më shpejt të jetë e mundur dhe të mbrojë sa më shumë infrastrukturën e Ibër Lepencit.

➤ **Ndarja e zyrave në Drejtori**

Në katin II dhe III do të bëhet furnizimi, punimi dhe montimi i dy zyreve të punuara-montazhë nga muri me knauf me dy shtresa dhe izolim brenda shtresave termoizolim dhe akustike me nga një dritare dhe derë kështu që në zyrën në katin III do të bëhet vendosja e arkivës për Departamentin e Financave.

Pasi që të përfundojnë punët e demolimit të sipërfaqes, propozohen ndryshimet që duhet bërë për funksionalizimin më të mirë të hapsirës.

Shërbimet e Përbashkëta

Në kuadër të shërbimeve të përbashkëta për vitin 2023 janë planifikuar këto investime kapitale:

➤ **Furnizimi me inventar për zyre**

Sipas kërkesave të punonjësve të ndërmarrjes shërbimi i logjistikës kanë vlerësuar gjendjen fizike të inventarit të zyreve dhe kanë konstatuar se një numër i konsiderueshëm i karrigeve dhe tavolinave janë dëmtuar dhe duhet të hiqen nga përdorimi. Më konkretisht, 65 karrige janë të dëmtuara dhe duhet të zëvendësohen me të reja. Me planin fillestar të biznesit ka kaluar kërkesa në shumë prej 8,000€, mirepo pasi kemi rishikuar sasine se janë amortizuar dhe dëmtuara 65 copë dhe pasi është shikuar çmimi i tregut kemi vendosur ti fuzionojmë kërkesat.

➤ **Renovimi i tualeteve në drejtori**

Tualetet e meshkujve, në katin 3 dhe katin 4 të objektit në drejtori janë në gjendje mjaft të keqe, gjithçka është e stërvjetruar. Renovimi parasheh ndërrimin e dyerve, pllakave dhe elementeve të sanitarisë.

➤ **Ndërrimi i perdeve në disa zyre të objektit në drejtori**

Kemi vlerësuar nevojën për ndrrimin e perdeve të quajtura "Perde shëtitore". Gjatë vlersimit nga shërbimi i logjistikës janë matur dhe si përfundim është konstatuar se në disa prej zyreve gjithsej janë 175 metër katror perde.

➤ **Furnizim me vazo me lule në katin e 3-të dhe të 4-të të objektit në Drejtori**

Vazot do të vendosen në koridore dhe disa zyre, në mënyrë që të krijohet një ambient më i mirë për punë.

➤ **Firewall, Router dhe Switch**

Projekti për vendosjen e Firewall-eve, Router-ve dhe Switcha- ve është planifikuar me planin e biznesit për 2023 po edhe kjo shumë e kërkuar është larguar një pjesë e mjeteve të planifikuara. Duke pasur parasysh gjendjen e sigurisë në fushën e teknologjisë informative në ndërmarrjen tonë po kërkojmë që të furnizohemi me pajisje të rrjetit konkretisht Firewall Router dhe Switcha të cilat do të ngrisin nivelin e sigurisë se informatave që ne si ndërmarrje posedojmë si në rrjetin lokal, ashtu edhe gjatë transferit mes objekteve tona.

Pra me pajisjet e kërkuara ne do të kemi mundësi që komunikimi mes katër objekteve kryesore të N.H. Ibër-Lepenc në njësitë punuese (NjP Shkabaj, NjP Vushtrrisë, NjP Komoran) dhe drejtoria në Prishtinë, të bëhet në mënyrë më të sigurtë falë konfigurimeve të sistemit siç është VPN.

Poashtu do të kemi edhe filtrim të komunikimeve të rrjetit për të ngritur nivelet e sigurisë. Rritja e sigurisë së qasjes në nivelin e rrjetit dhe rritja e sigurisë në nivelin e aplikacionit. Siguria e rrjetit është një veçori që mbron të dhënat, ndërsa ato udhëtojnë nëpër rrjetin që ne e posedojmë ne ndërmarrjen tone. Si rezultat, me rritjen e sigurisë së qasjes në të dhënat e firmës nga punonjësit që nuk janë të autorizuar të shikojnë informacione specifike të ndjeshme. Ky projekt do të implementohet edhe duke pasur parasysh rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe pajisjeve që afektohen nga siguria kibernetike duke ju referuar Ligjit Nr. 08/L-173, për Sigurinë Kibernetike të datës 2 shkurt 2023. Investimet në këtë projekt kapital 1xFirewall me tri vjet license, 4xRouter dhe 4xSwitcha me 24porta, 4xSwitcha me 48porta.

➤ **Cloud VPS Servera**

Ky projekt ka për qëllim që infrastruktura teknike e ndërmarrjes të modernizohet me shërbimet Server Cloud e që ofrojnë akses të kudondodhur dhe të përshtatshëm në rrjet, në burime të ndryshme kompjuterike. Serveri cloud është sikurse Serveri fizik, e i cili vendoset në një qendër të të dhënave, dhe i qasemi zakonisht përmes internetit, zakonisht nga shumë klientë. Serveri në cloud mund të kryejnë të njëjtat funksione të një serveri fizik tradicional, i vendosur në zyre, por duke ofruar fuqi përpunuese, ruajtje dhe mbrojtje nga dëmet me shumë se sa serveri në zyre. Disa nga avantazhet kryesore të serverit në cloud janë: Disponueshmëria (always on), Siguria, shkallueshmëria dhe Fleksibiliteti (mund të shtojmë resurse/pjesë në çdo

kohë), Ruajtja e të dhënave, Kursimet(energji, klima, ajrosja etj). Ky server do të shërbej si platformë ku do të hostohen (ruhen dhe ekzekutohen) aplikacionet ekzistuese dhe ato që do të vijnë.

➤ **Licenca dhe paisje të Teknologjisë Informative**

Furnizim me licenca për Office 365 për nevojat e N.H. Iber-Lepencit - ky projekt ka për qëllim të bëjë me furnizimin e s'paku 70 PC me licenca Office 365. Projekti është duke u bërë për përzgjedhjen e një Ofruesi Microsoft Office 365 që të kemi më të lehtë përdorimin e aplikacioneve si Word, Excel, PowerPoint e shumë të tjera, e të gjitha këto të jenë të përditësuara çdo muaj me veçoritë më të fundit! Me aplikacionet e Microsoft Office 365 po kërkojmë që të jemi në gjendje që t'i kryejmë punët tona kudo që ndodhemi, duke pasur qasje online deri në 5 PC/Pajisje të Ndërmarrjes.

➤ **Implementimi i projektit për evitimin e ujrave apo drenazhimin e objektit të zyrës së scadës në Shkabaj**

Rregullimi për evitimin dhe mbrojtjen e objektit të zyrës nga reshjet atmosferike në shkabaj e cila do të shërbej për menaxhimin e Scadës. Ndërhyrja në këtë projekt është të evitohet hyrja e ujit gjatë reshjeve të shiut në zyrën e Scadës në Shkabaj. Në të kaluarën ka hyre uji në këtë zyre andaj, e shoh të arsyeshme që urgjentisht të intervenojmë dhe ta sanojmë ekspozimin e dëmit i cili në çdo moment mund të ndodh përsëri.

➤ **Time Attendance Machine (Pajisje e hyrje/daljeve të punëtorëve)**

Pajisjet për sistemin e hyrje/daljeve duhet të ofrojnë një pasqyrë të qartë të lëvizjeve të punëtorëve brenda dhe jashtë objekteve përmes identifikimit të tyre, sikurse të ofroj edhe raporte gjithë përfshirëse për të lehtësuar dhe automatizuar procesin e kontrollit dhe të njehsimit të orëve të punës nëpër zyrat e administratës apo burimeve njerëzore.

Kërkojmë blerjen-ndërrimin e katër pajisjeve ekzistuese (katër copë që posedojmë si dhe 13 copë për pjesën e pikave të mbetura për integrim të tërë sistemit), për shkak se kemi probleme harduerike me to. Vlen të ceket se pajisjet janë të vjetëruara, amortizuara sepse janë blerë në fillimin e vitit 2017.

➤ **Furnizim me sistem të radiolidhjeve**

Radiokomunikimi është një mjet kritik në ndërmarrjet moderne për të siguruar komunikim të shpejtë, efikas dhe të sigurt në të gjitha nivelet e saj. Nevoja e radiokomunikimit në ndërmarrje është e rëndësishme për shumë arsye: Koordinim i efektshëm: Radiokomunikimi lejon ndërmarrjet të koordinohen në mënyrë efikase. Me anë të radios, punonjësit në terren, departamentet e ndryshme dhe menaxhmenti mund të komunikojnë menjëherë dhe të shkëmbejnë informacione të rëndësishme. Kjo siguron një bashkëpunim më të mirë dhe një

reagim të shpejtë në situata emergjente. Radiokomunikimi ofron një kanal të sigurt për të transmetuar informacione të ndjeshme dhe kritike, duke i shmangur rreziqet e shpërdorimit të informacionit. Përdorimi i kanaleve të enkriptuara dhe të ndarjes së frekuencave garanton që komunikimet të mbeten private dhe të mbrohen nga ndërhyrjet. Përmes këtij furnizimi do të pajisemi me 18 paisje statike, 20 mobile, 2 repititor, 8 bateria për repititor.

➤ **Furnizim me fotoaparate profesional**

Ky fotoaparate ka për qëllim që të krijojme imazhe dhe video me cilësi të lartë, e që shkojnë në favor të prezentimit sa më të mirë të nivelit të lartë të ndërmarrjes tonë. Aparati duhet të vie me sensorin CMOS me rezolucion 24.2 MP si dhe duhet ta ketë edhe mundësinë që të bëjmë video me rezolucion 4K për nevojat tona të ndërmarrjes. Fotoaparati po ashtu duhet të ketë interface micro HDMI, micro USB dhe WiFi, si dhe të mbështetë kartat e memories SD, SDHC dhe SDXC.

➤ **Blerja e dy makinave për pastrim-filtrim të ajrit**

Duhet të bëhet blerja e dy makinave për pastrim-filtrim të ajrit në vlerë në ambientet e arkivës pasi që në këto ambiente ka sasi të madhe dokumentacioni të vjetërsuar dhe kundërmon aromë jo të mirë, si dhe letrat lirojnë grimaca të pluhurit të cilat sigurisht se përbëjnë rrezik për shëndetin e punonjësve tanë.

➤ **Mjete për monitorimin e kanalit nga ajri**

Këto mjete do të rrisin sigurinë e kanalit dhe ujit nga ndonjë ndotje eventuale nga hedhja e gjesendeve të palejuara si dhe monitorimin e vazhdueshëm nga uzurpimet eventuale të pronave të Ndërmarrjes "Ibër-Lepenc" të cilat gjenden rreth kanalit dhe vende të tjera, si dhe kanali do të monitorohet në vazhdimësi dhe në mënyrë direkte do të mundësohet rritja e kontrollit me anë të së cilës do të rritej siguria e aseteve të ndërmarrjes, poashtu edhe imazhi i ndërmarrjes do të lartësohet.

➤ **Furnizimi me dy kondicioner industrial me inverter**

Ky projekt ka për qëllim të bëjë me furnizimin e dy kondicioner industriale me inverter të cilat janë pajisje të projektuara me saktësi e të përshtatura për të ruajtur vazhdimisht parametrat e kërkuar të lagështisë, temperaturës e rrjedhës së ajrit. Kondicionerët inverter i rezistojnë më shumë temperaturës, lagështisë dhe shpejtësive të qëndrueshme të ajrit.

Metodat e kondicionimit industrial janë të destinuara për fushat e veprimtarisë sikurse janë: dhomat e serverëve, qendrat e përpunimit të të dhënave, për dhomat e kompjuterëve. Në ndërmarrjen tonë na duhen tek SCADA Room-Dhoma e kompjuterëve dhe Server Room-tek SCADA projekti.

➤ **Inkorporimi i servitutit në SIKTK**

Sistemi i informatave të kadastrit të Kosovës (SITK) është modeluar për të qenë bazë e për administrimin e tokës në Kosovë, duke vendosur bazat e implementimit të një infrastrukture

moderne të informacioneve hapësinore dhe është duke ndjekur praktikën më të mirë të shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian në linjë me Direktivën INSPIRE 2007/2 KE të Parlamentit Europian.

NPH "Ibër Lepenc" në kuadër të njëres nga veprimtaritë e saj e ka edhe rrjetin nëntokësor për ujitje me një gjatësi prej 766 km, d.m.th. shtrirja e këtij rrjeti përfshinë tri fusha të operimit të shtrira në Komunitat Vushtrri, Mitrovicë, Obiliq, Fushe Kosovë, Drenas dhe Graçanicë, ku të dhënat grafike janë inkorporuar në sistemin e informatave të kadastrit të Kosovës (SIKT_G-pjesa grafike). Mirëpo, bazuar në ligjet relevante për administrim të tokës si dhe Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore është obligative edhe inkorporimi i servituteve (të drejtës së shfrytëzimit) në të dy bazat e të dhënave kadastrale pra në Sistemin e informatave të kadastrit të Kosovës SIKT -G (databaza grafike kadastrale) dhe Sistemin e informatave të kadastrit të Kosovës SIKT-T (databaza tekstuale kadastrale).

Futja (inkorporimi) i këtyre të dhënave bëhet konform këtyre ligjeve:

1. Ligji Nr.04-L/013 për Kadastër;
2. Ligji NR. 08/L-010 për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore;
3. Ligji Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.

➤ Software për zyrën për pronë (gjeodezi)

Detyra themelore e profesionit të gjeodezit është mbledhja e të dhënave në terren, në bazë të të cilave bëhen planet dhe hartat. Gjatë gjithë historisë, anketuesit kanë përdorur metoda të ndryshme matjeje, duke u përpjekur gjithmonë të përdorin teknologji të reja për të kryer matjen më saktë dhe me efikasitet më të madh. Zhvillimi i pajisjeve elektronike matëse gjeodezike filloi në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Me kalimin e kohës, saktësia dhe shpejtësia e mbledhjes së të dhënave u rrit, dhe ndoshta pika më e rëndësishme është se procesi i regjistrimit të të dhënave të matura ishte plotësisht i automatizuar. Stacionet moderne matëse gjeodezike ofrojnë mundësi të shumta dhe përpunim të automatizuar të të dhënave, por ato rrallë janë të adaptueshme për nevojat e përdoruesve. Rezultati është zhvillimi i programeve me porosi nga anketuesit në kalkulatorë të ndryshëm të programueshëm. Në njëzet vitet e fundit, pajisjet celulare kanë avancuar ndjeshëm teknologjikisht dhe sot shpesh tejkalojnë aftësitë dhe fuqinë përpunuese të kalkulatorëve të xhepit. Punimi trajton zhvillimin e një aplikacioni për pajisjet mobile, qëllimi i të cilit është të zgjidhë operacionet e shpeshta llogaritëse në gjeodezi. Duke qenë se është një platformë celulare, funksionet e aplikacionit janë përshtatur për punë në terren, megjithëse mund të jenë po aq të dobishme në zyrë. Rezultati i punës është një aplikacion celular për platformën Android që përfshin disa nga operacionet bazë të llogaritjes që lidhen me gjeodezinë dhe përdorë aftësitë e avancuara të telefonave celularë për të ofruar zgjidhje të reja që mund të jenë të dobishme në terren.

Në tabelën e poshtëshënuar janë paraqitur 3 SET (kompletet) e pajisjeve të GNSS-së si dhe aplikacionit software-ik.

	Pajisjet GNSS
SET1	Stacion Total Robotic
SET2	GNSS Rover plus Kontroller i GPS

SET3

Aplikacioni Software-ike

Tabela 7: Investimet kapitale për vitin 2023 dhe projeksioni deri në vitin 2025

Nr.	Projekti	Realizimi	Realizimi	Projeksioni	Projeksioni	Projeksioni
		2022	2023	2023	2024	2025
I. Njësia afariste “UJI DHE GJENERIMI”						
1	Penda Ujman	-	-	60'000	50'000	50'000
1.1	Penda Ujman dhe Pridvorice - Intervenimet në Pendë			60'000	50'000	50'000
2	HC Ujman	-	-	100'000.00	100'000.00	100'000.00
2.1	HC Ujman -Riparimi I turbinave,gjeneratorëve dhe stabilimenteve			100'000	100'000	100'000
3	Sanimet dhe rehabilitimi	272'922	130'127	790'305	605'000	15'000
3.1	Sanimi I rreshqitjes se dheut ne Babin Most dhe kanalit ne segmentin Mihaliq-Besi-Gracanke			328'305		
3.2	Mirembajtja,sanimi dhe renovimi i kanalit kryesor dhe sekondar	68'725			400'000	
3.3	Sanimi dhe renovimi i SP Bivolak		68'028			
3.4	Sanimi i ON dhe SP (Besi,Cagllavice,Pantine,Samadregje,Fushtice,Gjurashin,Koratice Krashtice)			210'000	100'000	
3.5	Mirembajtja eLargëpërquesve 10kV dhe 35 kV	6'199		7'000	25'000	15'000
3.6	Furnizim me material teknik për punëtorin mekanike Shkabaj	23'802		8'000		
3.7	Ndërrimi i valvulave Ø 600 dhe Ø 400 në SP Bivolak	34'692				
3.8	Ndërrimi i ndërprersave 10kV në SP Samadregjë ,Fushticë dhe SP Pantinë.	31'500				
3.9	Shqyrtimi i transformatorëve dhe mbrojtjeve	4'708	4'637			
3.10	Ndërrimi i ndërprersave 10kV në SP Gjurashin, SP Krashticë dhe NJ. P. Shkabaj		39'589			
3.11	Ndërrimi i Ridrejtuesit 380V(AC) / 110V (DC) / 24V (DC) në SP Besi		17'873			
3.12	Ndërrimi i sistemit hidraulikë për ON Hamidi, ON Mihaliq, ON Vërnice dhe ON Vasilevë.				80'000	
3.13	Rehabilitimi I fluturakeve (kllapneve) te valvulave jo kthyesë në SP Besi	5'935				
3.14	Furnizimi dhe instalimi(ndërrimi) i baterive stacionare ne SP- Besi, SP,- Bivolak.	14'870				
3.15	Furnizimi dhe montimi i vinçit për ngritjen e automjeteve në NJP Shkabaj	3'133				
3.16	Ndërtimi I rrethojës të bazenit akumulues ne SP Besi	68'199				
3.17	Furnizimi me pompa zhytëse, drenazhes dhe litarit te celikut te vinçit ne SP Besi si dhe 3 pompa uji me motorr dizel	7'525				
3.18	Riparimi i motorit te Eskavatorit JCB	3'633				
3.19	- Vendosja e Elektromotorve dhe mekanizmit (AUMAVE) për hapjen dhe mbylljen e valvulave Ø=600, në SP Bivolak, - Furnizimi dhe montimi i valvulës Ø=200 në SP Bivolak. - Riparimi i pompave të drenazhës në SP Besi			40'000		
3.20	Studimi I Fizibilitetit krijimi i specifikacionit) për sistemin Hidraulik(në ON) , pulteve komanduese si dhe modernizimin për rritjen e efciencës në SP,			20'000		
3.21	Traktor per pastrimin e kanaleve sekondare			20'000		
3.22	Gjenerator disel 150kV, per Hidrocentralin e Ujmanit dhe Gjenerator 10kV(per Komoran)			17'000		

3.23	Ndertimi dhe vendosja e urave metalike per kembesor pergjate kanalit kryesor			50'000		
3.24	Furnizimi deh montimi I tabelave sinjalizuese pergjat kanalit			20'000		
3.25	Hidroizolimi i bazeneve kompenzuese në SP			70'000		
Total - NJ.A. "UJI dhe GJENERIMI"		272'921.65	130'126.99	950'304.83	755'000.00	165'000.00
II. NJ. A. UJITJA						
1	Furnizim me fazoneri	127'378		120'000		
2	Eskavator per Njesin Punuese Vushtri		93'220			
3	Mjete pune (2 kompresor dhe 3 demolues-Hillta)	2'655				
4	Riparimi I banjove dhe ngjyrosja e objektit në Nj.P Shkabaj	4'391				
5	Furnizim me Lidhëse Riparuse (shellne)			5'000		
6	Ndertimi I Garazhit (Depo per ruajtjen e Fazonerive) dhe Rehabilitimi i Çatisë se Nj.P Komoran			70'000		
Total NJ. A. UJITJA		134'424.00	93'220.00	195'000.00	-	-
III. Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim						
1	Vendosja e video kamerave në NJP,SP dhe ON	477.83		25'000		
2	Renovimi I Objektit të Drejtorisë				400'000	
3	Studimi ii fizibilitetit per shfrytësimin e asetëve te IL-se per prodhim te energjise alternative			20'000		
4	Programi i sigurisë kibernetike			20'000	100'000	
Total - Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim		477.83	-	65'000.00	500'000.00	-
IV. Shërbimet e përbashkëta						
1	Furnizim me teknologji informative(kompjuter,printera, etj.)	25'416	15'000			
2	Inventar për zyre	1'859		29'700		
3	Firewall, Router dhe Switch-a			40'000		
4	Inkorporimi i servitutit ne SIKTK			60'000		
5	Software per zyren e gjeodezisë				2'000	
6	Stacion Total Robotic				15'000	
7	Kontroller I GPS				10'000	
8	WEB faqja e Ndërmarrjes	3'500				
9	Cloud VPS Servera			15'000		
10	Licenca dhe pajisje për teknologji informative				100'000	
11	Renovimi I tualetëve në objektin e Drejtorisë			13'000		
12	Rregullimi i drenazhës për evitimin e hyrjes së ujit gjate reshjeve te shiut në zyrën e Scadës në Shkabaj			5'000		
13	Time Attendance Machine (Pajisje e hyrje/daljeve të punëtorëve)			15'000		
14	Furnizimi me dy kondicioner industrial me inverter			3'000		
15	Ndarja e zyreve ne drejtori			10'000		

16	Furnizimi i istemit të radiolidheve			60'000		
17	Furnizim me fotoaparate profesionale			2'000		
18	Blerja e dy makinave për pastrim-filtrim të ajrit			2'000		
19	Mjete për monitorimin e kanalit nga ajri			90'000		
Total - Shërbimet e përbashkëta		30'775	15'000	344'700	127'000	-
Gjithsej (I + II + III + IV)		438'599	238'347	1'555'005	1'382'000	165'000

Planifikimi i Burimeve njerëzore

Personeli

Numri aktual i të punësuarëve në ndërmarrje aktualisht është si në vijim:

- 277 punëtorë aktiv;
- 7 punëtorë pushim pa pagesë;
- 6 punëtorë do të pensionohen deri në fund të vitit 2023;
- 8 do të punësohen deri në fund të këtij viti sipas planit të vitit 2023;

Zhvillimi i burimeve njerëzore në Iber Lepenc është i përshtatur me aktivitetet që ndërlidhen me arritjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes. Marrë parasysh këtë fakt, ndërmarrja ka krijuar politika dhe procedura të cilat sigurojnë se stafi do të kontribuojë sa më mirë për arritjen e këtyre objektivave. Këto politika mbulojnë planifikimin e burimeve njerëzore, rekrutimin dhe selektimin, trajnimin dhe zhvillimin e aftësive të reja, menaxhimin e performancës, krijimin e një ambienti të sigurt për punë, sigurimin e barazisë gjinore, përfshirjen e minoriteteve dhe pakicave etj. Ndërmarrja në vazhdimi është koherente me ndryshimet në legjislacionin të cilat ndërlidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe bën azhurnimet e nevojshme në rregulloret dhe politikat e brendshme bazuar në ato ndryshime. Për më tepër, burimet njerëzore në vazhdimi përshtaten sipas objektivave strategjike të ndërmarrjes duke bërë lëvizje të stafit sipas nevojave të departamenteve dhe në harmoni me profilet e punëtorëve.

Gjatë vitit 2023 do të pensionohen 6 të punësuar, të cilët do të zëvendësohen nga punëtorët aktual të ndërmarrjes ose përmes punësimeve të reja. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri aktual i stafit, pensionimet, zëvendësimet dhe punësimet e reja për vitin 2023.

Punësimet/zëvendësimet për vitin 2023 do të bëhen si në vijim:

- 2 në Administratë (Gjeodet, ekspert për GIS)
- 4 në "Uji dhe Gjenerimi" (2 Teknik, 2 Inxhinier)
- 1 në Auditim (Auditor)
- 1 në zyrën e Sekretarit (Sekretari i Kompanisë)

Tabela 8: Numri i punëtorëve sipas njësive afariste dhe departamenteve

	Kabineti i KE	Sekretari	Njësia zbatuese BB	Administrata	Burimet njerezore	Zyra Ligjore	Financat	Prokurimi	Plan dhe Zhvillim	Auditimi	UJI dhe CE	Ujitja	Total Ndërmarrja
Numri aktual	11	1	4	39	5	3	15	3	10	1	91	94	277
Pensionimet/ Zevendesimet											5	1	6
Punësimet		1		2						1	4		8
Totali:	11	2	4	41	5	3	15	3	10	2	90	93	279

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Në bazë të kërkesave të sektorëve do të bëhet një analizë e nevojave për trajnime dhe mbi këtë analizë do të hartohet plani i trajnimeve. Trajnimet duhet të jenë të fokusuara konform nevojave të stafit për njohuri të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së detyrave në ndërmarrje duke mbuluar trajnimet e domosdoshme për ngritje profesionale.

Shkathtësitë dhe zhvillimi i stafit janë shumë të rëndësishme për ndërmarrjen duke pasur parasysh që stafi profesional ndihmon në arritjen më të shpejtë dhe më të lehtë të objektivave të përcaktuara në këtë plan biznesi.

Planifikimi Financiar

Buxheti i ndërmarrjes për vitin 2023 është përpiluar në bazë të:

- Madhësi fizike të prodhimit dhe shërbimeve;
- Nevojave materiale për të siguruar procesin e punës;
- Vlerës së aseteve.

Shpenzimet janë shprehje e kërkesave të departamenteve, respektivisht të njësive punuese duke pasur parasysh çdo herë racionalizimin e tyre në një shkallë të mundur. Buxheti i ndërmarrjes në vitin 2023, do të jetë buxhet unik, për të cilin participojnë njësitet dhe departamentet dhe do të jetë në funksion të ndërmarrjes si tërësi. Mirëmbajtja investive si dhe pagat e punëtorëve janë pjesa më e madhe e buxhetit.

Buxheti për paga është kalkuluar bazuar në numrin e pritur të punëtorëve të cilët do të marrin paga gjatë vitit 2023, ndërsa kompensimi për shujtë është në vlerë 3 euro.

Në vitin 2023, pritet të realizohen të hyrat në shumën totale prej **8,938,649 €** ndërsa shpenzimet operative planifikohen të jenë **5,314,323€**. Investimet kapitale të planifikuara për vitin 2023 janë në shumë prej **1,793,351.82€**.

Planifikimi i Fitimit/Humbjes për vitin 2023

Tabela 9. Rezultati operativ vjetor 2023

1	Të hyrat	8'938'649
2	Shpenzimet operative	5'314'323
3	Rezultati financiar (1-2)	3'624'326
4	Zhvlerësimi (amortizimi)	4'665'220
5	Fitim / Humbja neto (3-4)	-1'040'894

Struktura dhe vlera e të hyrave për vitin 2023

Tabela 10. Plani i të hyrave vjetore 2023

PLANI I TË HYRAVE TË NDËRMARRJES				
Nr.	Emërtimi	Realizimi 2022	Plani 2023	(+/-) %
1	2	3	4	5(4:3)
1	Njësia afariste Uji dhe Gjenerimi-Energjia elektrike	7'060'943	6'504'707	92.12
2	Njësia afariste Uji dhe Gjenerimi-Uji i papërpunuar	2'363'495	2'286'299	96.73
3	Njësia afariste Ujitja	176'389	143'000	81.07
4	Të hyra tjera	44'252	4'643	10.49
	Gjithsej	9'645'079	8'938'649	92.68

Shpenzimet operative

Tabela 11. Plani i shpenzimeve për vitin 2023

PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2023				
Nr.	Emërtimi	Realizimi 2022	Plani 2023	(+/-) %
1	2	3	4	5
1	Pagat e punëtorëve	2'961'563	3'039'436	102.63
2	Kompensimi për BD	25'638	37'426	145.98
3	Shërbimi shëndetësor	71'051	83'122	116.99
4	Puna jasht orarit	55'157	70'061	127.02
5	Pagat përcjellëse	20'018	37'990	189.79

6	Kompensimi për shujtë	161'893	208'233	128.62
7	Shpenz. e udhëtimëve zyrtare	1'579	14'159	896.94
8	Shpenz. e reprezentacionit	11'013	20'894	189.72
9	Shpenzimet e marketingut	280	940	335.71
10	Shpenzimet e mirëmbajtjes	26'234	61'018	232.59
11	Shpenzimet komunale	272'129	284'406	104.51
12	Materiali hargjues	24'471	25'584	104.55
13	Material për ndërrimin dhe riparimin e gypave në rrjetin e ujitjes	56'936	91'024	159.87
14	Shpenzimet për shërbime	46'633	131'697	282.41
15	Detyrime kontigjente dhe kompenzimi i dëmëve		188'333	
16	Shpenzime tjera	257'236	260'001	101.08
17	Shpenzimet e telekomunikimit	10'524	25'435	241.70
18	Derivatet	51'215	60'218	117.58
19	Provizionet dhe taksat	582'683	637'344	109.38
20	Shpenzimet nga imbalanca		37'000	
I	Shpenzimet operative	4'636'251	5'314'323	114.63
II	Zhvlerësimi (amortizimi)	4'629'756	4'665'220	100.77
	Gjithësej (I+II) :	9'266'007	9'979'543	107.70

Tabela 12. Rezultati financiar për vitin 2023

REZULTATI FINANCIAR 2023				
Nr.	Emërtimi	Realizimi 2022	Plani 2023	(+/-) %
1	2	3	4	5
1	Të hyrat	9'645'079	8'938'649	92.68
2	Shpenzimet operative	4'636'251	5'314'323	114.63
3	Rezultati financiar (1-2)	5'008'828	3'624'326	72.36
4	Zhvlerësimi (amortizimi)	4'629'756	4'665'220	100.77
5	Fitim / Humbja (3-4)	379'072	-1'040'894	-274.59

Plani i zhvlerësimit të aseteve për vitin 2023

Tabela 13. Plani i zhvlerësimit për vitin 2023

	Objekte ndërtimore		Makinat e rënda		Paisjet		Gjithsej	
	Vlera blerëse	Zhvlerësimi 2022	Vlera blerëse	Zhvlerësimi 2022	Vlera blerëse	Zhvlerësimi 2022	Vlera blerëse	Zhvlerësimi 2022
1	2	3	4	5	6	7	8 (2+4+6)	9 (3+5+7)
Shërbimet e përbashkëta	2,196,079	43,075			715,436	44,210	2,911,515	87,285
Uji në tërësi	170,011,263	3,327,419			3,676,444	13,795	173,687,708	3,341,214
Centrali elektrik	79,078,946	846,613	4,151,110	83,022			83,230,056	929,635
Ujitja	30,103,999	272,515			2,138,286	34,571	32,242,284	307,086
GJITHSEJ:	281,390,286	4,489,622	4,151,110	83,022	6,530,167	92,576	292,071,563	4,665,220

Parashikimi i rrjedhës së parësë së gatshme për vitin 2023

Tabela 14. Rrjedhja e parësë së konsoliduar për vitin 2023

	Janar I	Shkurt II	Mars III	Prill IV	Maj V	Qershor VI	Korrik VII	Gusht VIII	Shtator IX	Tetor X	Nëntor XI	Dhjetor XII	Totali
Bilanci fillestar - Paratë në bankë (CASH-i)	5,007,515	5,254,759	5,826,536	6,189,790	6,108,136	6,895,633	6,528,445	6,172,313	5,832,480	5,297,254	4,601,924	4,341,826	
Të hyrat (inkasimet)													
Energjia	626,870	897,295	1,121,714	93,165	1,123,360	192,007	177,500	177,500	106,500	106,500	106,500	88,750	4,817,660
Uji i papërpunuar	119,582	154,363	73,096	247,227	149,420	259,908	243,356	241,939	220,595	188,555	183,509	186,376	2,267,926
Ujitja	1,793	1,608	251	186	1,780	2,920					143,000		151,537
Të hyra tjera	1,522	3,873	3,677	2,697	2,539	2,214							16,522
Totali i të hyrave	749,767	1,057,139	1,198,738	343,275	1,277,099	457,049	420,856	419,439	327,095	295,055	433,009	275,126	7,253,645
Shpenzimet (pagesat)	502,524	476,111	556,511	355,358	428,223	784,648	508,060	490,345	593,394	442,484	424,179	423,150	5,984,986
Kthimi i Kredis BB			278,973							278,974			557,947
Mirëmb. investive		9,250		69,571	61,379	39,589	268,927	268,927	268,927	268,927	268,927	268,927	1,793,352
Bilanci përmbyllës i CASH-it	5,254,759	5,826,536	6,189,790	6,108,136	6,895,633	6,528,445	6,172,313	5,832,480	5,297,254	4,601,924	4,341,826	3,924,875	

Parashikimi financiar për projektin e Bankës Botërore

Buxheti sipas planit të punës për vitin 2023 WSCP - N.H. "Ibër Lepenc" Prishtinë													
Nr	Pershkrimi i projektit	Emërtimi	Vlerësuar 15'000'000.00	2023									
				Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shkator	Telor
SIGURIA E UJIT DHE MBROJTJA E KANALET - WSCP													
Komponenta 1:													
A	Rehabilitimi i Kanallit kryesor të Ibrer Lepencit	WSCP-W-ICB-1						1'287'519.16			2'000'000.00		1'000'000.00
B	SCADA Project	WSCP-G-ICB-2											100'000.00
Komponenta 2:													
A	Mbikqytja dhe konsulenca - IPE Proing	WSCP-CS-QCIBS-2			69'571.48						31'942.40		47'790.00
Komponenta 3:													
A	Ndërtimi i bazenit/digës së Mihaljaqit	WSCP-W-ICB-3											
Menaxhimi i projektit													
A	WSCP-CS-LCS-1								2'500.00	2'500.00			
A	Audillimi	WSCP-CS-CQ-3											
C	Menaxhimi dhe monitorimi mjedisor	WSCP-CS-IC-4/5/6/7											
D	Paneli i ekspertëve ndërkombëtar të digave												10'000.00
Konsulentët individual të projektit													
1	Specialistët ndërkombëtar të prokurimit	WSCP-CS-IC-8						17'325.00				5'000.00	
2	Eksperti financiar (Lokal Part-time)	WSCP-CS-IC-9	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00
3	Eksperti mjedisor (Lokal Part-time)	WSCP-CS-IC-10	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00
4	Inzhinier i lartë i ndërtimtarisë (Lokal Full-time)	WSCP-CS-IC-11	1'300.00	1'300.00	1'300.00	1'300.00	1'300.00	1'300.00	1'300.00	1'300.00	1'300.00	1'300.00	1'300.00
5	Zyrtar administrativ dhe monitorues (Lokal Full-time)	WSCP-CS-IC-12	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00
6	Zyrtar ndërtimtar dhe i lartë (Lokal Full-time)	WSCP-CS-IC-13	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00	940.00
7	Zyrtar ndërtimtar dhe i lartë (Konsulentët Serb - Full-time)		600.00	600.00	600.00	600.00	600.00	600.00	600.00	600.00	600.00	600.00	600.00
Menaxhimi i projektit													
1	Shpenzime graduale		300.00	300.00	300.00	300.00	300.00	300.00	300.00	300.00	300.00	300.00	300.00
2	Promovimi dhe rendesia e projektit										2'000.00		2'500.00
3	Trajnimi dhe ngritja profesionale e stafit	WSCP-TR										500.00	500.00
Total Projekt Buxheti													
			4'980.00	4'980.00	74'061.48	4'490.00	1'309'334.16	6'990.00	36'482.60	2'004'040.00	6'040.00	57'330.00	1'104'540.00
													€ 4'680'098.24

Buxheti sipas planit të punës për vitin 2023 WSCP - N.H. "Ibër Lepenc" Prishtinë - Pjesa e ME

Komponenta 3. Ndërtimi i bazenit/diges se Mihaljaqit - Ministria e Ekonomise													
• Bazenit/diga e Mihaljaqit													
Vërejtje: Ky nënprojekt është tërheqë prej projektit WSCP nga Ministria e Ekonomise. Ibër Lepenc dhe Banka Botërore dhe nuk ka planifikim në të ardhmen													
3 Komponenta 2: Projektimi, mbikqytja dhe konsulenca - Ministria e Ekonomise													
• Projektimi, mbikqytja dhe konsulenca													
Total Projekt Buxheti - Ministria e Ekonomise													
Total Projekt Buxheti (Janar - Prill 2022)													
			7'000'000.00										
													€

Plani i b

Bajram MUSTAFA
Kryesues i Bordit të Drejtorëve
të NPH "Ibër Lepenc"

